

REPREZANTIMI I DHUNËS NË MEDIA (PORTALE) NDAJ FËMIJËVE

GJATË VITEVE 2020-2021

TEMA PËR TITULLIN

MASTER I ARTEVE NË PSIKOLOGJI SHKOLLORE DHE KËSHILLIM

NGA

SYZANA BAFTIU



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

FAKULTETI FILOZOFIK

DEPARTAMENTI I PSIKOLOGJISË

KORRIK, 2021

Reprezentimi i dhunës në media (portale) ndaj fëmijëve gjatë viteve 2020-2021

Syzana Baftiu

Mentori/ja: Kaltrina Kelmendi, Prof. Ass. Dr.

Dhuna është një dukuri e përhapur globalisht e cila prek të gjithë njerëzit, duke mos kursyer edhe fëmijët. Ajo ndikon seriozisht në shëndetin fizik dhe psikologjik të tyre.

Hulumtimet e shumta dëshmojnë se më shumë se 1 miliard fëmijë, gjysma e të gjithë fëmijëve në botë janë të ekspozuar ndaj dhunës çdo vit (Hillis, Mercy, Amobi, & Kress, 2016).

Dhuna është një zhanër i vendosur në media i cili daton që nga civilizimet antike dhe është një nga format më të njohura të argëtimit! Këto ekspozime, qofshin ato afatshkurtra ose afatgjata, mund të rezultojnë me pasoja negative psikologjike, duke përfshirë rritjen e sjelljes agresive dhe një nivel të ulët të emocioneve ndaj veprimeve të dhunshme dhe mund të pengojnë aftësinë e fëmijës për të qenë fizikisht aktiv (Rouse, 2011).

Me paraqitjen e fazave të hershme të pandemisë Covid-2019 fëmijët u përshkruan si transportues të padukshëm që përbënin rrezik të infeksionit tek të tjerët. Si rezultat i kësaj ekspozimi i fëmijëve ndaj dhunës dhe neglizhencës është rritur. Duke parë këtë rritje dhe mungesën e studimeve të tilla në kontekstin e Kosovës, qëllimi i këtij studimi është të shikoj se si reprezentohet dhuna në media ndaj fëmijëve gjatë viteve 2020-2021 dhe ti ofrojë mediave mundësinë për të punuar rreth parandalimit të dhunës ndaj fëmijëve. Prandaj ky studim do ti përgjigjet pyetjes kërkimore e cila është: Si reprezentohet dhuna në media ndaj fëmijëve?

Për të realizuar këtë studim fillimisht janë zgjedhur tre portale të Kosovës të cilat kanë

reprezantuar lajmet e dhunës ndaj fëmijëve gjatë viteve 2020-2021. Këto portale janë: Kallxo.com, Koha.net dhe Indeks Online. Për secilin nga portalet janë marrë lajmet nga një periudhë kohore prej 6 muajsh. Kallxo.com ka përfshirë lajmet Janar – Qershor 2020; Koha.net ka përfshirë lajmet Korrik – Dhjetor 2020; dhe Indeks Online ka përfshirë lajmet Janar – Qershor 2021. Arsyeja e kësaj ndarje ka qenë shmangia e përsëritjes së lajmeve të njëjta.

Ky hulumtim është i dizajnit kualitativ dhe është realizuar përmes mbledhjes së lajmeve të cilat kanë reprezentuar dhunën ndaj fëmijëve në media. Analiza e përmbajtjes (Content Analysis) është përdorur si një mjet kërkimor për të përcaktuar praninë e fjalëve, temave ose koncepteve të caktuara brenda disa të dhënave cilësore. Konkretisht kjo analizë është marrë me përmbajtjen e temave të dhunës në portale. Pas mbledhjes së 232 lajmeve, janë koduar 1865 kode, të cilat janë gjeneruar në 20 kategori tematike dhe 7 tema kryesore.

Rezultatet tregojnë se gjatë viteve 2020-2021 në periudhën e pandemisë Covid-19 , dhuna ndaj familjes është rritur dhe kjo dhunë ka përfshirë edhe fëmijët. Ajo ka qenë e të gjitha formave duke përfshirë dhunën fizike, psikike, seksuale dhe neglizhencën. Gjithashtu kanosjet, trafikimi me qenie njerëzore, prostitucioni dhe rrëmbimet kanë qenë prezente gjatë këtyre viteve. Lajmet gjithashtu tregojnë se pasojat e kësaj dhune kanë qenë nga më të lehtat deri tek ato më të rëndat, dhe se një numër i madh i viktimave kanë pranuar tretman dhe ekzaminim mjekësor. Në përgjithësi lajmet janë të reprezentuara në formë sipërfaqësore dhe nuk japin detaje për arsyet se pse ka ndodhur dhuna. Megjithatë disa nga shkaqet e paraqitura kanë qenë: mosmarrëveshjet, të qenit nën ndikimin e alkoolit, problemet psikike që kanë pasur ushtruesit e dhunës dhe situata me pandeminë Covid-19.

Duke parë përhapjen e dhunës dhe efektet e mediave mbi audiencën, mediat e lira dhe të pavarura, në përputhje të plotë me sistemin e tyre vetërregullues, mund të luajnë një rol të

fuqishëm në ndërtimin e një kulturë të respektimit të të drejtave të fëmijës dhe të veprojnë si partnerë të natyrshëm në zbatimin e strategjisë. Mediat duhet të inkurajohen për të edukuar si fëmijët edhe të rriturit për të drejtat e fëmijës, të promovojnë pjesëmarrjen e fëmijëve, të mbështesin praktikat e prindërimit pozitiv, të forcojnë dialogun ndërkulturor dhe ndërfetar, dhe të nxisin vlerat jo të dhunshme në shoqëri.

Gjithashtu prindërit kanë një përgjegjësi të veçantë sa i përket aksesit dhe përdorimit të mediave në shtëpi dhe në shkollë. Ata mund të marrin këtë përgjegjësi në mënyra të ndryshme, duke përfshirë përdorimin e vetëdijshëm dhe selektiv të medias, nxitjen e qëndrimeve kritike të fëmijëve, kufizimin e aksesit në përmbajtjen që mund të ndikojë negativisht në mirëqenien fizike, emocionale ose psikologjike të fëmijëve.